



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Bailiff Services Albania

Tiranë, më datë 05.02.2020

Nr. 155 .Prot
Nr.1285.Regj

VENDIM

Për shpalljen në ankand të III të pasurisë së paluajtshme

Pranë Zyrës Përbarimore Private “Bailiff Services Albania” sh.p.k, është depozituar kërkesa e palës kreditore “Credins Bank” sh.a. në date 09.12.2013 sëbashku me **Urdhërin e Ekzekutimit nr. 12-2012-2185 datë 12.09.2012** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë të lëshuar për **Kontraten e Kredisë Afatgjate nr.28/date 18.09.2008, nr.2032 rep, nr.921 kol date 22.09.2008 me pale:**

- Kreditor: “Credins Bank” sh.a.
- Debitor: Skender Gjumsi
- Dorëzanës: P.F “Skender Gjumsi”, Kimete Gjumsi
- Objekti: Kthim kredie

Në bazë të nenit 517 të K.Pr.Civile i është komunikuar palës debitore njoftimi për kryerjen e ekzekutimit në mënyrë vullnetare. Me marrjen dijeni nga ana e palës debitore nuk është vepruar për shlyerjen e detyrimit. Për rrjedhojë në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile për të bërë të mundur ekzekutimin e titullit, ekzekutimi është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të palës debitore. Pasi është vendosur masa e sekuestros nga ana jonë i është dërguar njoftim palëve debitor dhe kreditor që brenda afatit ligjor prej 7 (shtatë) ditësh të caktojnë me mirëkuptim ndërmjet tyre çmimin e pasurisë së paluajtshme. Megjithatë afati ka kaluar pranë zyrës përbarimore nuk është depozituar asnjë marrëveshje për caktimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme. Për rrjedhojë për vlerësimin e pasurisë së sekuestruar në përputhje me nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar ekspert i licensuar i cili ka kryer vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të palës debitore. Në bazë të aktit të ekspertimit të paraqitur nga eksperti si dhe mbështetur në nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar çmimi i pasurisë së paluajtshme. Ky çmim i’u është komunikuar palëve në proces ekzekutimi sëbashku me aktin e vlerësimit të pronës. Gjithashtu i është lënë afat palës debitore për të shlyer detyrimin por nga ana e saj nuk është vepruar, si dhe pranë zyrës përbarimore nuk është depozituar asnjë vendim gjyqësor për pezullimin e veprimtarisë përbarimore. Me Proces verbalin e datës 26.11.2019 është zhvilluar ankandë i parë për pasurinë e paluajtshme Nr.4/164-ND, vol 4, faqe 22, ZK 3234, lloji i pasurisë (ndertese) me sip 70 m², me adrese Rrogozhine, në pronësi të Skender Haziz Gjumsi, me vlerë 5,600,000 leke, i cili është mbyllur duke mos u arritur të shitet sendi.

Me pas procedura përbarimore ka vijuar me vendim për caktimin e vlerës së sendit të paluajtshëm Nr 2638 Prot., datë 02.12.2019 dhe më pas me vendim për shpalljen në ankand të dytë të pasurisë së paluajtshme Nr 2877 Prot datë 16.01.2020.

Më datë 03.02.2020 është mbajtur procesverbali i ankandit të dytë, i cili gjithashtu është mbyllur pa asnjë ofertues.

Në këto kushte në bazë të nenit 557 të K.Pr.Civile duhet të zhvillohet ankandi i tretë për shitjen e pasurisë së paluajtshme me një çmim të ri jo më të ulët se 10 përqind të çmimit të përcaktuar në ankandin e dytë.

Në bazë të nenit 577 të K.Pr.Civile.

VENDOSA

1-Të shpall ankandin e III (tretë) për shitjen e pasurisë së paluajtshme me 10% zbritje nga vlera e vlerësuar nga eksperti, për pasurinë:

- -Pasuri nr.4/164-ND, vol 4, faqe 22, ZK 3234, lloji i pasurise (ndertese) me sip 70 m², me adrese Rrogozhine, ne pronesi te Skender Haziz Gjumsi.

Çmimi i pasurisë në ankand të tretë është në masën 3 528 000 Leke.

2-Secili ofertues duhet të depozitoje si garanci në llogarinë e Zyrës Përmbartimore Private “Bailiff Services Albania” sh.p.k. me nr. NIPT L02127004B shumën prej 10% të çmimit fillestar, në numrin e llogarisë pranë Credins Bank sh.a.

IBAN AL 4621 2110 1600 0000 0000 253 135 nr. llog. 00000 25 31 35 (leke)

3-Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 05.02.2020 deri në datë 19.02.2020 dhe do të zhvillohet po më këtë datë në orën 16:00 pranë zyrës përmbartimore private “Bailiff Services Albania” sh.p.k

4-Publikimi i këtij ankandi kryhet konform nenit 568 të K.Pr.Civile.

5-Ky vendim i komunikohet palëve, të cilët kundër tij kanë të drejten e ankimit brenda 5 diteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.

**Zyra Përmbartimore Private “Bailiff Services Albania” sh.p.k
Përmbartues Gjyqësor Privat
ERION LLALLA**

